Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1026

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare dhe Isa Hasani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së OE "Bahri Asllani", kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me transformator 400MVA, 24 400 kV për njësinë B1" me numër të prokurimit KEK-23-7573-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "Korporata Energjetike e Kosovës" sh.a., më 09/02/2024, mori këtë:

Vendim

1. **Refuzohet**, si e pabazuar ankesa e "Bahri Asllani" me nr. 2023/1026 , e datës 18/12/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me transformator 400MVA, 24 400 kV për njësinë B1", me numër të prokurimit KEK-23-7573-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "Korporata Energjetike e Kosovës" sh.a.

2.Vërtetohet Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues – "Korporata Energjetike e Kosovës" sh.a lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3.Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 20.07.2023, "Korporata Energjetike e Kosovës" sh.a. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me transformator 400MVA, 24 400 kV për njësinë B1" me numër të prokurimit KEK-23-7573-

1-1-1. Ndërsa me datën 20.11.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë "Ballkan Petrol SH.P.K"

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 5,000,000.00 €.

Me 27.11.2023, OE "Bahri Asllani" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 06.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 18.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Bahri Asllani" me nr. 1026/23 lidhur me aktivitetin "Furnizim me transformator 400MVA, 24 400 kV për njësinë B1" me numër të prokurimit KEK-23-7573-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Bahri Asllani" janë parashtruar si në vijim**:**

Autoriteti Kontraktues, me datën 20.07.2023 e kishte shpallur njoftimin për kontratë me nr. të prokurimit KEK-23-7573-1-1-1 nr. të brendshëm KEKC-23-282-1-1-l, me titullin e kontratës të dhënë nga Autoriteti Kontraktues: "Furnizim me Transformatorë 400 MVA, 24 400 kV për njësinë BI". Në këtë aktivitet të prokurimit kishin konkurruar dy operatorë ekonomike dhe atë: Ballkan Petrol SH.P.K, Zona Industrial Gërlicë, 70,000 Ferizaj për vlerën totale të ofertës prej 4, 749,601.00 €; dhe - Bahri Asllani, Rx. Agim Ramadani, Aktash Cl/9, 10,000 Prishtinë, për vlerën totale të ofertës 4,722,888.64 €

Autoriteti Kontraktues në datën 19.10.2023 e kishte nxjerrë Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të përshkruar si me lartë përmes të cilit i kishte njoftuar Operatoret Ekonomik konkurrues se Korporata Energjetike e Kosovës SH.A e shpërblen me kontratë ofertuesin "Ballkan Petrol SH.P.K," Ferizaj në vlerën prej 4, 749,601400 €. Me datën 24.10.2023 ne OE N.T.SH "Ekoinvest" kemi paraqitur përmes platformës se E- Prokurimit Kërkesën për Rishqyrtim për projektin "Furnizim me Transformatorë 400 MVA, 24 400 kV për njësinë BI" me nr. të prokurimi KEK-23-7573-1-1-1, me nr. të brendshëm KEKC-23-282-l-1-1 brenda afatit prej 5 ditësh pas Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues me datën 27.102023 ka publikuar ne platformen e E-Prokurimit njoftimin mbi Vendimin e AK ne Kërkesën për Rishqyrtim ku e ka cilësuar kërkesën tonë si pjesërisht të bazuar dhe kthyer lenden ne ri-vlerësim. Me datën 20.11.2023 Autoriteti Kontraktues pas

*procesit te ri-vlerësimit e kishte nxjerrë Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të përshkruar si me lartë përmes të cilit i kishte njoftuar Operatoret Ekonomik konkurrues se Korporata Energjetike e Kosovës SH.A e shpërblen me kontratë ofertuesin "Ballkan Petrol SHP *K," Ferizaj në vlerën prej 4,749,601.00 €. Me datën 27.11.2023 ne OB N, T.SH "Ekoinvest" kemi paraqitur përmes platformës se E Prokurimit Kërkesën për Rishqyrtim ndërsa me datën 06.12.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar ne platformën e E-Prokurimit njoftimin mbi Vendimin e AK ne Kërkesën për rishqyrtim ku e ka cilësuar kërkesën ton si të pa bazuar.*

Njoftimi mbi vendimin e AK i datës 20.11.2023 është vendim i kundërligjshëm, me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, me aplikim te gabuar të dispozitave të ligjit material dhe atë për faktin se e kanë shpërblyer me kontratë OE "Ballkan Petrol SH.P.K" i cili ne mënyrë të faktuar është i pa përgjegjshëm dhe OE "Bahri Asllani" në mënyrë të kundërligjshme e kanë shpallur të pa përgjegjshëm. Ndërsa përveç kundërligjshmërisë, vendimi i lartë cekur është edhe arbitrarë me elemente të dyshim të bazuar te ekzistimit te veprës penale të shpërdorimit të detyrës zyrtare me të vetmin qellim qe ti hapet rrugë OE të favorizuar nga ana e individëve të papërgjegjshëm pasi qe shkeljet e njëjtat janë bere nga ana e zyrtareve të Autoritetit Kontraktues edhe gjate fazës se ri-vlerësimit . Në vijim të kësaj Kërkese/Ankese do ta trajtojmë fillimisht papërgjegjshmërinë e OE "Ballkan Petrol SH.P.K" pastaj do ta faktojmë dhe argumentojmë përgjegjshmërinë e OE "Bahri Asllani BI — Ekoinvest" dhe krejt në fund do ti potencojmë arbitraritetin dhe elementet e dyshimit të bazuar për vepra penale. Papërgjegjshmëria e OE "Balkkan Petrol SH.r.K" OE i cekur si më lartë është i papërgjegjshëm për procedurën e prokurimit të cekur si ne piken I të kësaj kërkese për arsyet si në vijim: Në dosjen e Tenderit (faqe 24) Kërkesat që OE duhet ti plotësoj, pjesë e Anex l, me pikën 5 përcaktohet "Prodhuesi duhet të dëshmoj me dokument se posedon laboratorin e testimeve për transformatorë energjetikë për tensione të larta sipas standardit IEC dhe duhet të dëshmoj se ka kryer së paku një testë--një transformatori- të-fuqisë-400MVA-dhe-klasë Itensioni-400-kV-apo-më-të-lartë, Të dëshmohet me raport të testimit nga prodhuesi.

Shkelja e pare: OE "Ballkan Petrol SH.P.K" kishte dështuar që të paraqesë dokumentacion me të cilin do të dëshmonte (Siç kërkohet "Prodhuesi duhet të dëshmoj me dokument") mbi licencën e laboratorit dhe/apo certifikatën e akreditimit të laboratorit te prodhuesit. Ndërsa OE "Ballkan Petrol SH.P.K si "dokument" ka prezantuar një deklarate dhe disa fotografi. AK ne mënyre arbitrare dhe te kundërligjshme ka pranuar si "Dëshmi" një dokument te krijuar vet se posedon laborator (shih provën l), Pra, OE i rekomanduar për kontratë ka dështuar që të ofrojnë dokument valid/dëshmi nga ndonjë instancë kredibile (pra certifikatë) dhe ne vend të saj i ka lëshuar vetes deklarata në formatin e letrave të thjeshta. I njëjti është dashur te shpallet i papërgjegjshëm për mungese te një dokumenti valid qe e vërteton posedimin e laboratorit. Fakti se AK ka bere shkelje flagrante duke rekomanduar për kontrate një OE te papërgjegjshëm i cili kishte dështuar në përmbushjen e këtij kriteri është i pakontestueshëm pasi qe këtë e vërteton edhe vendimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit i datës 10.02.2023 P.SH, nr 694/22 në faqe 4 pasuesi i parë, pika 3 ishte theksuar: "Ankuesi ka pohuar po ashtu se OE i rekomanduar nuk ka ofruar dëshmi bindëse dhe/ose të mjaftueshme lidhur me posedimin e laboratorit testues. Lidhur me këtë eksperti ka konstatuar(nga hulumtimet e tija) se ky pohim i ankuesit është i bazuar pasi që edhe përkundër deklaratës nga OE dhe nga Prodhuesi se posedon laborator për testim, OE dhe Prodhuesi ka dështuar të ofrojë dokument dëshmues valid/dëshmi nga instancë tjetër kredibile dhe jo ti lëshojë vetës një dokument dhe një foto ne formatin e deklaratës"(shih prova nr.2).

Shkelja e dytë: Imagjinoni se deri ku shkon arbitrariteti dhe kundërligjshmëria e vendimit te Autoritetit Kontraktues, ku ne kërkesën e radhës (pjese e Annex 1, pika 5): "Duhet të dëshmoi se ka kryer se paku një test të një transformatorit te fuqisë 400 MVA dhe klasë tensioni 400KV apo me te lartë . Të dëshmohet me raport të testimit nga prodhuesi. Me këtë rast OE i rekomanduar për kontrate ka dështuar të përmbush kërkesën e tillë pasi qe ka dorëzuar një raport te testimit nga një laborator tjetër respektivisht nga ndërmarrja ORGREZ a.s divize Elektrotechnich Laboratori, Vitkova 17, Praha 8-Karlin, 186 00 (shih prova nr: 3). dhe jo nga laboratori i prodhuesit siç është kërkuar ne këtë pike te Annex I . Shkelja e lartcekur po ashtu e vërteton se prodhuesi (ETD Transformatory as.) me të cilin ka ofertuar OE "Ballkan Petrol SH.P.K" nuk posedon "laboratorin e testimeve për transformator energjetik për tensione të larta sipas standardit IEC siç është kërkuar ne dosjen e tenderit.

Shtrohet pyetja; Ky arbitraritet i komisionit vlerësues a ka mundur të jetë i paqëllimshëm ?? , apo ne mënyre të hapur dhe kundërligjore tentohet ti krijohet rruge OE te favorizuar duke i mbyllur sytë dhe kamufluar ne mënyre te qëllimshme kërkesat shume te qarta te dosjes se tenderit. Pra përveç faktit- se -Autoriteti Kontraktues i mbyll sytë përpara,, -mungesës së dokumentit se prodhuesi posedon laboratorin e testimeve (kriter të Cilin e ka përcaktuar vetë AK) dhe faktit se Autoriteti Kontraktues është koshient se nuk është ofruar raporti i testimit nga vetë prodhuesi (kriter të Cilin e ka përcaktuar vetë AK), këto nuk kanë mundur të ndodhin rastësisht apo nga ndonjë formë e pakujdesisë sepse nga vendimi i OSHP i përshkruar në pikën I l të kësaj kërkese vërtetohet se edhe OSHP-ja Vitin e kaluar (për te njëjtin projekt, për te njëjtën kërkese) ka konstatuar se prodhuesi duhet të posedojë dokument dëshmues valid nga instanca kredibile (certifikatë) dhe jo t i lëshojë vetës deklarata. (shih prova .nr. 2)

Të lartcekurat e vërtetojnë se vendimi i atakuar me këtë kërkese është i kundërligjshëm madje ka argumente mjaft bindëse që qojnë ne dyshimin e bazuar se personat përgjegjës të Autoritetit Kontraktues kanë konsumuar edhe elemente të veprës penale (per qka nuk do të zgjerohemi shume por do t iii drejtohemi organeve kompetente) vetëm e vetëm që ta shpallin fitues një Operator Ekonomik të papërgjegjshëm sipas dosjes së tenderit dhe në anën tjetër të përmes veprimeve veprime te arbitrare dhe te kundërligjshme Operatorin Ekonomik Bahri Asilani B. - EKOINVEST shpallin papërgjegjshëm.

Përgjegjshmëria e Operatorit Ekonomik Bahri Asllani B.I.-EKOINVEST : Ne Fletën e të Dhënave të Tenderit në pikën 8.1 & 8.2 Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar ishte kërkuar "(shënim premtues) që konfirmon se kompania mund të marr kredi prej 5 MIL Euro Operatori Ekonomik Bahri Asllani B.I. — EKOINVEST, me qëllim të plotësimit të këtij kriteri nga Dosja e Tenderit e kishte ofruar pranë Autoritetit Kontraktues Letër Mbështetjen nga Raiffeisen Bank Kosova "S.C për Korporatën Energjetike të Kosovës Sh.A në Prishtinë me numër RBKO Ref: MD2324800002 të datës 05.09.2023 (shih prova nr.4). në të cilën ishte theksuar "Ne vërtetojmë se N.T.SH. Ekoinvest / Bahri Asllani BI. Prishtinë Kosovë, NUI 810906620 është klient i bankës tonë Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C. Ne mund të mbështesim N.T.SH. Ekoinvest / Bahri Asllani B.I., rruga Agim Ramadani Prishtine Kosovë me EUR 5,000,000.00 (me fjalë 5 Milion Euro) kredi për implemetinimin e projektit/tenderit: Furnizim me Transformator 400 MVA, 400Kv për njësinë BI me numër të prokurimit KEK-23-7573-1-l-1 dhe me numër të brendshëm KEKC-23-282-1-l-1, nëse klienti i plotëson kushtet e brendshme te bankës për një kreditim të tillë. (Plotësimi i vetëm i kushteve te brendshme te bankës është nënshkrimi i kontratës pasi qe hipoteka veq se është- e përmbyllur me Aktvendim mbi regjistrimin e hipotekës? Marrëveshja kryesore nr. 10 95 ne vlerë prej 10.000.000,00 (dhjetë milion) Euro me vlefshmëri prej

dalës14122018 deri me 14.122028) (shih prova 5) . Nga Dosja e Tenderit pika 8.1 & 8.2 dhe Letër Mbështetja e apostrofuar më lartë vërtetohen në mënyrë të pakontestueshme rrethanat si në vijim: Vërtetohet se kërkesë e dosjes së tenderit (e përcaktuar me pikën 8.1 & 8.2) është vërtetimi bankar (shënim premtues) se kompania mund të marrë kredi prej 5 Milion Euro. Pra nuk kërkohet një kredi e aprovuar (shih kërkesën e DT dosjes së tenderit nga pika 17) por kërkohet një letër mbështetje - shënim premtues se kompania mund të marrë kredi 115 shumën prej 5 Milion Euro. Kjo letër mbështetje e lëshuar nga RBKO bazohet ne "A K T V E N D M I N" mbi regjistrimin e hipotekës Marrëveshja Kryesore me nr.1095 ne vlerën (dhjetë milion) e arritur me date 14.12.2018 deri me 14,1242028 (shih prova m- 5). Nga Mbështetja me RBKO Ref: MD2324800002 datës 05.09.2023 konfirmohet se banka e lartcekur mund ta mbështet NTSH Ekoinvest Bahri Asllani Bl. me 5 Milion Euro me limit kredie apo over-draft duke u bazuar ne aktvendimin dokumenti marrëveshja e lartcekur për implementimin e projektit/tenderit: Furnizim me Transformator 400 MVA, 400kv për njësinë B.I me numër të prokurimi.t KEK-23-7573-11-1 dhe me numër të brendshëm KEKC-23-282-l-l-l. Pra Letër Mbështetja është akt tjetër ndërsa aprovimi i kredisë finalizohet me një kontratë fuqiplotë me kredinë. Prandaj në procedurën e prokurimit (pika 8.1 & 8.2) nuk kërkohet një kredi e aprovuar por kërkohet një shënim premtues. Prandaj shënimi premtues nuk duhet të nënkuptohet si kredi e aprovuar. Ndërsa në pjesën ku thotë se: "Gjithashtu ne, Raiffisen Bank Kosova J.S.C Robert Doli, Prishtinë, Kosovë nuk kemi dhe nuk pranojmë asnjë përgjegjësi financiare ndaj përfituesit dhe autoritetit kontraktues në bazë të këtij dokumenti lëshuar nënkupton se kjo Letër Mbështetje nuk paraqet ndonjë përgjegjësi financiare ndaj përfituesit ose Autoritetit kontraktues. Gjë që është plotësisht e qartë dhe e kuptueshme se raportet kredi marrëse janë raporte kontraktuale ne mes të bankës si kredi dhënës dhe përfituesit të kredisë si kredi marres dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese rregullohen përmes kontratës mbi kredinë (si akti i dy anshëm detyrues).

Nga kjo që u theksua në pikën 19 të kësaj kërkese vërtetohet në mënyrë të saktë dhe të plotë se Operatori Ekonomik "Ekoinvest" Bahri Asllani Bl. e ka plotësuar në mënyrë të plotë dhe pas as një mëdyshje kriterin e përcaktuar ne pikën 8.1 & 8.2 te dosjes se tenderit. Për të mbështetur legjitimitetin tonë se posedojmë kapacitete të mjaftueshme financiare për përmbushjen e kërkesave të parapara ne FDT ju paraqesim AKTVENDIMIN mbi regjistrimin e hipotekës me nr. Protokolli: 011-944-1/1352/ 18. Marrëveshja kryesore me nr. 1095 me vlere prej 10.000.000 C nga e cila buron letër Mbështetje e lëshuar nga Raiffeisen Bankë me numër referent: MD2324800002 e datës: 05.09.2023 dhe ne këtë dokument (shih provën 5) është e bazuar Letra e Mbështetjes nga banka Raiffeisen me numër RBKO Refi MD2324800002 të datës 05.09.2023. Përmes paraqitjes se AKTVDNDIMIMIT mbi regjistrimin e hipotekës i cili është valid deri me datën 14.12.2028, dëshmojmë se jemi legjitim ne përmbushjen kriterit te përcaktuar në pikën 8.1 & 8.2 të dosjes së tenderit dhe jo vetëm por i tejkalon ato. Autoriteti Kontraktues me veprimet arbitrare dhe të kundërligjshme dhe ne mënyrë te qëllimshme ka dale jashtë procedurave te LPP duke shkelur rregullat për sqarime shtese te përcaktuar me ligi, duke i bere pyetje sqaruese palës se trete (shih prova nr, 6) dhe ne mënyre te njëjte abuzive ka kamufluar kërkesën e dosjes se tenderit duke e pyetur palën e trete: "të konfirmoni se Operatori ekonomik(përfituesi) Ekoinvest / Bahri Asllani B.I. ka limite të aprovuar për qasje në kredi në dispozicion prej 5 Milion Euro" !!! ndërsa kërkesa e Dosjes se Tenderit është se kërkohet shënim premtues se mund te merret kredi për vlerën 5 Milion Euro Forme tjetër te shënimit premtues përveç letrës se mbështetjes nuk ka. Te vetmen pyetje palës se trete sipas Ligjit te Prokurimit mund ti behet se "a është lëshuar nga ju apo jo" ndërsa Operatorit Ekonomik mund ti kërkohen dokumentet origjinale-dhe-sqarime-shtesë ne kete rast komisioni deklarues ka shkelur deklaratën nen betim duke komunikuar me individ te palës se trete, duke vene ne lajthitje me pyetje e bëra te cilët kane konsumuar elemente

të veprës penale si dhe palën e trete e ka futur ne konsumim te veprës penale pasi qe e njëjta ka shkelur ligjin mbi privatësinë duke shpalosur informacion konfidencial. Në këtë mënyrë përmes arbitraritetit dhe kundërligjshmërisë ishin munduar ta konfuzojnë Letrën Mbështetëse me limitet e aprovuara të kredisë gjë që janë dy qështje të ndara (vetëm e vetëm të krijojnë amulli dhe paqartësi në një Letër mbështetje e Cila është shumë e saktë në aspektin përmbajtjesor dhe gjuhësor). Në përgjigje të këtij emali-i Raiffeisen Bank iu kishte përgjigjur me datën 06.10.2023 në të cilën kishte theksuar "çdo vendim mbi kreditimin bazohet në kushtet dhe kriteret tona të brendshme". Veprimet e AK te cilat tashme përmbajnë shkelje të përsëritura ligjore për të dytën here ngjallin dyshime të bazuara se OE i rekomanduar me kontrate është duke u favorizuar nga individ brenda AK dhe për këtë arsye kërkojmë qe të behet një inspektim - ekspertize e detajuar për përmbushjen apo mos përmbushjen e kapaciteteve financiare te dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë respektivisht,, rreth vërtetësisë & dhe vlefshmërisë se tyre. Të gjitha këto veprime të Autoritetit Kontraktues janë më shumë se një vendim i kundërligjshëm sepse për Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë i mbyll sytë përballë fakteve të pakontestueshme e të cilat janë të përshkuara në pikat 6 deri 17 të kësaj kërkese dhe e shpall të përgjegjshëm Operatorin Ekonomik i cili është i papërgjegjshëm e që është Ballkan Petrol Sh.p.k ndërsa për Operatorin Ekonomik ankues N.T.SH Ekoinvest / Bahri Asllani B.I merr një mori veprimesh arbitrare dhe të kundërligjshme vetëm e vetëm që ta shpalle të papërgjegjshëm. Ne njërën ane, për këtë veprim nga komisioni i parë vlerësues dhe komunikimet me individ jashtë KEK(duke qene nen betim) përmes se cilës ka vene ne lajthitje palën e trete dhe ne bashkëveprim me te ka bere shkelje te Ligjit mbi privatësisë dhe shpalosjes se sekreteve afariste, ekziston dyshimi i bazuar se është kryer vepër penale ne bashkëpunim, veprim te cilin jemi te detyruar ta denoncojmë për keqpërdorim te detyrës zyrtare dhe shkelje te deklaratës nen betim. Rrjedhimisht për veprimet e tilla te trajtuara me lartë do të njoftohet edhe prokuroria kompetente. Ndërsa, ne anën tjetër komisioni i dyte vlerësues ka vazhduar rrugën e njëjtë dhe nuk e ka marre as edhe mundimin me te vogël për te kërkuar sqarime shtese, përkundrazi nuk ka përfillur informacionet e afruara nga ne."

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, 7, 11, 59, 60, 72 të LPP –së, si dhe 28, 42, 39 te rregullores se prokurimit publik. Duke propozuar qe ankesën ta aprovoi pretendimet tona ankimore dhe lenden ta kthejë ne rivlerësim.

Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim: *"Me datën: 27.11.2023, Autoriteti Kontraktues ka pranuar kërkesën për rishqyrtim e parashtruar nga OE "EKOINVEST" lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me transformator 400MVA, 24 400 kV për njësinë BI" me nr. prokurimit KEK-23-7573-1-1-1.*

Konform nenit 108/A, të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/1-068 dhe ligjin Nr. 05/1-092, pas ekzaminimit të Dosjes së tenderit dhe shqyrtimit të rrjedhjes së procedurës së tenderimit, komisioni i Autoritetit Kontraktues në bazë të kërkesës për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik sqaron me sa vijon:

Autoriteti Kontraktues (AK) ka shqyrtuar me kujdes pretendimet ankimore dhe konstaton se kërkesa për rishqyrtim nuk pasqyron gjendjen faktike pasi qe nuk është marre fare parasysh procesi i ri-vlerësimit te ofertave (nuk keni kërkuar dhe nuk keni pasur qasje ne raportin e ri-vlerësimit), por pretendimet ankimore janë të njëjtat te paraqitura ne kërkesën e pare për rishqyrtim.

Pretendimet ankimore dhe përgjigjet e komisionit te Autoritetit Kontraktues:

1. Pretendimi ankimor lidhur e kërkesën e specifikimi teknik — pika nr. 5: Prodhuesi duhet të dëshmoj me dokument se posedon laboratorin e testimeve për transformator energjetik për tensione të larta sipas standardit IEC dhe duhet të dëshmoj se ka kryer se paku një test të një transformatori te fuqia 400MVA dhe klasë tensioni 400 ki/ apo më të lartë. Të dëshmohet me raport të testimit nga prodhuesi.

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues:

a) Pretendimi ankimor lidhur me kërkesën e pikës nr.5 (pjesa e pare) - "duhet te dëshmoj me dokument se posedon laboratorin e testimeve për transformator energjetik për tensione të larta sipas standardit IEC.

Meqenëse lënda është kthyer ne ri-vlerësim (vetëm për këtë pretendim) për tu sqaruar me ne detaje kjo çështje, komisioni i ri-vlerësimit ka trajtuar me kujdes ketë kërkesë te dosjes se tenderit gjate ri-vlerësimit duke kërkuar sqarime shtese nga njësia kërkuese lidhur me këtë pikë te specifikimit teknik.

Ne baze te sqarimit te pranuar nga njësia kërkuese, kërkesës se dosjes se tenderit, sqarimeve te dosjes se tenderit, komisioni i ri-vlerësimit ka konstatuar se OE "Ballkan Petrol" me dokumentacionin e dorëzuar ne oferte i plotëson kërkesat e kësaj pikë të specifikimit teknik.

Për me tepër, komisioni i ri-vlerësimit ka bere hulumtime edhe ne internet dhe ka konstatuar se prodhuesi ETD ka laboratorin e certifikuar sipas standardeve dhe kjo mund te gjendet ne linkun: https://etd-transformers.com/e-t-l/

Pra, ky pretendimi ankimor është tërësisht i pabazuar, nuk pasqyron gjendjen faktike dhe se nuk është marre për bazë procesi i ri-vlerësimit

b) Pretendimi ankimor, lidhur me kërkesën e pikës nr.5 (pjesa e dytë) — "duhet të dëshmoj se ka kryer së paku një test të një transformatori të fuqisë 400MVA dhe klasë tensioni 400 kV apo më të lartë. Të dëshmohet me raport të testimit nga prodhuesi"-

Është e habitshme për AK qe prapë përsëritet pretendimi ankimor i njëjtë edhe pse është sqaruar nga AK me vendimin (përgjigjen ne kërkesën për rishqyrtim) te datës 27.10.2023, se Operatori Ekonomik i propozuar për kontratë ka prezantuar test raportin ne emër të prodhuesit "SHKODA-ETD" dhe me këta prodhuesi ka dëshmuar se ka prodhuar dhe testuar transformatori të fuqisë 400MVA dhe klasë tensioni 400 kk/ sipas kërkesës se dosjes se tenderit. Kompania ORGREZ ka kryer analizat kromotografike te vajrave e jo testimet e transformatorit.

Pra, ky pretendimi ankimor është tërësisht i pabazuar, nuk pasqyron gjendjen faktike.

2.Pretendimi ankimor lidhur me përgjegjshmërinë e Operatorit Ekonomik ankues lidhur me kërkesat e gjendjes ekonomike/financiare konkretisht kërkesës se dosjes se tenderit — qasja për

kredi ne dispozicion.

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues: Pretendimi ankimor i lartcekur është i pabazuar pasi përmes dokumentacionit te prezantuar, sqarimeve te pranuara nga lëshuesi i dokumentit nuk keni plotësuar kërkesën e dosjes se tenderit: Operatori Ekonomik duhet te ketë te paktën 5 mil. euro asete likuide financiare ose qasje për kredi ne dispozicion. Ne kërkesën për rishqyrtim duke qene ne dijeni se nuk plotësoni ketë kërkese jeni munduar te anashkaloni kërkesën e dosjes se tenderit dhe te thirreni vetëm ne dëshminë. Për me tepër, Autoriteti Kontraktues ketë çështje e ka sqaruar përmes përgjigjeve te dhëna ne kërkesat për sqarim para hapjes dhe te njëjtat janë dërguar te gjithë operatoreve ekonomik te interesuar te cilën e ka pranuar edhe kompania juaj dhe është sqaruar si ne vijim: Duhet te dorëzohet vërtetim nga një apo disa banka me te cilat dëshmohet se OE ka qasje për kredi ne dispozicion ne vlere prej 5 mil. euro.

Duke qene ne dijeni se nuk e keni plotësuar ketë kërkese dhe nuk e keni argumentuar/faktuar edhe me pretendimet ne kërkesën për rishqyrtim, me datën 25.10.2023 një dite pas dorëzimit te kërkesës për rishqyrtim (një muaj e gjysme pas hapjes se ofertave) keni ngarkuar ne platformën e-prokurimi dokumentacion shtese me te cilin keni tentuar te dëshmoni se me këtë dokument do te plotësohet kërkesa e lartcekur. Dorëzimi i dokumentacioni shtese është ne kundërshtim me nenin 72 te ligjit te prokurimit publik si dhe legjislacionit sekondar për prokurim publik.

Dokumenti i dorëzuar është i pas afatshem, nuk i plotëson kërkesat e dosjes se tenderit si dhe përmes këtij dokumenti mundoheni te veni ne lajthitje Autoritetin Kontraktues dhe organet tjera (OSHP) qe mund te përfshihet ne ketë aktivitet te prokurimit

Sa i përket pretendimit tuaj për inspektim dhe ekspertize te dokumenteve financiare te dorëzuara nga OE "Balkan Petrol" është i paqëndrueshëm, i pa arsyetuar si dhe i pambështetur ne ndonjë argument valid me te cilin do te vinit ne dyshim vërtetësinë e dokumenteve te cilave i referoheni.

Komisioni i ri-vlerësimit pas ekzaminimit te gjithë dokumentacionit nuk gjen ndonjë shkas ,prove, arsye apo njohuri objektive për te dyshuar ne vërtetësinë dhe vlefshmërinë e këtyre dokumenteve.

Sa i përket pretendimit ankimor se është shkelur ligji mbi privatësinë duke shpalosur dokument konfidenciale (përgjigja ne këtë pretendim është dhënë me vendimin e AK te datës 27.10.2023) është i paqëndrueshëm dhe i pabazuar, për arsye se autoriteti kontraktues nuk i ka shpalosur dokumentet konfidenciale ndonjë pale te trete dhe çdo veprim i ndërmarre ka qene ne pajtueshmëri te plote me nenin 11 te LPP-se. KEK-u nuk është pale e trete për Raiffeisen Bank ne rastin konkret pasi qe dokumentin e lëshuar për ketë aktivitet te prokurimit e ka te adresuar për KEK-un. AK ka kërkuar sqarime plotësuese nga Raiffeisen Bank dhe nga askush tjetër dhe sipas LPP-së ka te drejtën për te sqaruar çdo paqartësi për secilin dokumentin ofertues te lëshuar Operatoret ekonomik për AK. Komisioni i ri-vlerësimit ka bere vlerësimin e ofertave ne pajtueshmëri me nenin 59 të LPP-se si dhe ka trajtuar ne mënyre te barabarte te gjithë OE siç parashihet ne nenin 7 të LPP-së dhe konstaton qe te gjitha pretendimet ankimore janë te pabazuara. Bazuar në sqarimet e dhëna më larte për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me transformator 400MVA, 24 400 kV për njësinë BI " me nr. të prokurimit KEKC-22-152-1-1-1 rekomandon qe te refuzohet si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim."

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 29/12/2023 ka autorizuar eksperten shqyrtuese për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1026/23, ndërsa me datë 07/01/2024 është dorëzuar raporti i ekspertes shqyrtuese me nr. 2023/1026 me rekomandimet si në vijim: "Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertes shqyrtuese, ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertes, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "Bahri Asllani",eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/1026 ka vlerësuar si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

• ***Sqarim hyrës****, Me datën: 17.12.2023, OE "Bahri Asllani" B.I - NTSH "EKOINVEST - Prishtinë, me ankesën numër: 2023/1026, ka shprehur rezervat dhe kundërshtimet e tyre në lidhje me Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontaktues (AK), ku rekomandohet për kontratë OE "Ballkan Petrol" SH.P.K Ferizaj në lidhje me prokurimin e aktivitetit: "Furnizim me transformator 400MVA, 24 400 kV për njësinë B1", me numër të prokurimit "KEK-23-7573-1-1-1", i nisur nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS" sh.a.*

Autoriteti kontraktues ka ndjekur një procedurë të hapur për këtë kontratë furnizim, duke përcaktuar llojin e kontratës si furnizim, me një vlerë parashikuar prej: 5,000,000.00 €. OE "Bahri Asllani" B.I - NTSH "EKOINVEST - Prishtinë" ka shprehur nevojën për një shqyrtim të hollësishëm dhe të drejtë të procedurave të ndjekura nga Autoriteti Kontaktues (AK), duke identifikuar çdo aspekt të papranueshëm në rekomandimin për kontratë nga Autoriteti kontraktues për përcaktimin e shpërblimit të kontratës në fjalë. Kjo ankesë synon të sigurojë transparencën dhe drejtësinë në procesin e prokurimit.

Pretendimi nr. 1. Eksperti shqyrtues jep mendimin e tij në lidhje me pretendimin ankimor 1, pasi ka administruar dhe shqyrtuar me kujdes shkresat që lidhen me faktet dhe argumentet në platformën elektronike e - prokurimi, rrjedhën dhe analizën e procedurës për këtë aktivitet të

prokurimit të lartë përmendur, për pretendimin ankimor të OE ankues Bahri Asllani B.I NTSH "EKOINVEST" më tej si parashutës i ankesës, pretendimi ankimor sipas dosjes së tenderit për pjesën e Anex 1, piken 5 siç është kërkuar në DT, citoj kërkesën e DT-së: (5. Prodhuesi duhet të dëshmoj me dokument se posedon laboratorin e testimeve për transformator energjetik për tensione të larta sipas standardit IEC dhe duhet të dëshmoj se ka kryer së paku një test të një transformatori të fuqisë 400MVA dhe klasë tensioni 400 KV apo më të lartë. Të dëshmohet me raport të testimit nga prodhuesi.).

Prandaj duke e marruar për bazë sqarimet e Operatorëve Ekonomik OE, sipas neni 53 të LPP-së AK me datën: 11.08.2023 ka ngrit në platformë elektronike përgjigjeje lidhur me Aneksin 1 të DT-së pika 4 citoj: Lidhur me pikën 2 b) KEK pajtohet me atë që OE ne ofertën e vetë ta prezantoj një Deklaratë nga prodhuesi se testet që kërkohen sipas IEC dhe ISO do të kryhen nga institute të pavarura të certifikuara nga trupa certifikuese në ambientet e prodhuesit apo prodhuesi nëse posedon laborator testues të certifikuar sipas standardeve të aplikuara. Që do të thotë se AK ka lejuar të ofrohet deklarata nga prodhuesi (këto përgjigjeje më sqarime bëhen pjesë s Dosjes së tenderit), andaj OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar Deklaratën nga prodhuesi për testim, Declaration for testing laboratory nga prodhuesi ETD Transformatory a.s. duke bashkëlidhur edhe test Laboratory equipment of EDT Transformatory a.s., sipas dosjes së tenderit (DT) dhe përgjigjëjet e autoritetit kontraktues AK të datës: 11.08.2023, që do të thotë se OE i rekomanduar për kontratë ka plotësuar kërkesat e DT –së dhe AK ka vepruar në pajtim me neni 59 të LPP-së. Duke e parë vendimin në kërkesë për rishqyrtim të datës: 06.12.2023 tek pretendim 1 pika a) komisioni ri vlerësues ka konfirmuar përmes hulumtimit në Ueb faqen e prodhuesit i se prodhuesi posedon Certifikatën e Akreditimit për Laborator Testimi me nr. 298/2023 ne emër te ETD TRANSFORMATORY a.s për Laborator te Testimeve Elektrike me validitet deri me 09.06.2028.

Sa i përket pjesës ku OE ankues i referohet pjesës se dyte te kërkesës 5 te dosjes se tenderit "duhet të dëshmoj se ka kryer së paku një test të një transformatori të fuqisë 400MVA dhe klasë tensioni 400 kV apo më të lartë" eksperti shqyrtues sqaron se me oferte OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar certifikata testuese për TESTIME TE TRANSOFRMATORIT nga SKODA ENERGO sro me nr prot: 60TK/267/00 për tensionin 410kv. OE ankues nuk e ka vërejtur dokumentin e mësipërm te bashkangjitur ne ofertën e OE te rekomanduar për kontratë por i është referuar një dokumenti tjetër te lëshuar nga ORGREZ a.s i cili ne përkthim është për "Analyses of insulating oil" (analiza e vajit izolues) dhe si rrjedhoje nuk është paraqitur gjendja faktike nga pretendimi i elaboruar nga OE ankues.

AK gjate vlerësimit te ofertave ka vepruar në përputhje me nenin 40.4 dhe 40.6 te RRPP 001/2022 lidhur me nenin 59 të LPP-së. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK-së te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë nuk është i qëndrueshëm.

Eksperti shqyrtues jep mendimin e tij në lidhje me pretendimin ankimor 2, eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe

pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në pretendimi nr. 2 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se Dokumenti lëshuar nga banka Raiffaisen Bank është në pajtim me kërkesat e Dosjes së tenderit.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare neni 8.1& 8.2 të FDT-së, si në vijim:

Bazuar në sqarimet shtesë sipas nenit 53 te LPP-se dhe përgjigjet nga AK te datës: 11.08.2023 si ne vijim:

Bazuar ne Letrën Mbështetëse te datës: 05 Shtator 2023 të lëshuar nga Raiffasen Bank lëshuar për OE ankues lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, në të cilën thuhet, po citoj: "Gjithashtu ne Raiffaisen Kosovo J.S.C. Robert Doll nr. 9, Prishtina, Kosovë, nuk kemi dhe nuk pranojmë asnjë përgjegjësi financiare ndaj përfituesit dhe/ose autoritetit kontraktues në bazë të këtij dokumenti të lëshuar", andaj lidhur me këtë AK – me datën: 29 Shtator 2023 në pajtim me nenin 59 par. 2 te LPP-se, përmes e-maili-i i drejtohet zyrtarit të bankës i cili e ka lëshuar ketë dokument i cili është nënshkruar dhe vulosur, duke kërkuar sqarime sikurse ne vijim:

Po ashtu eksperti shqyrtues vlerëson se përkundër sqarimeve te kërkuara Banka e OE ankues ne asnjë rast nuk ka pranuar se do ta mbështesë klientin e tij dhe ka konfirmuar se citoj: "letërkëmbimi i mëparshëm nuk përfaqëson një zotim financiar nga ana jone" dhe "nuk është një garanci se kjo shume do te jete e disponueshme për klientin".

AK – komisioni i vlerësimit ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit si dhe OE ankues, ku potencon në letrën standarde të eliminimit se edhe pas sqarimeve/përgjigjeve nga Raiffaisen Kosovo J.S.C. – zyrtari përgjegjës (i cili ka nënshkruar dhe vulosur dokumentin – letër mbështetje ref. MD2324800002); nuk janë në "pajtim" me kërkesat e dosjes së tenderit dhe përgjigjet e dhëna nga AK te datës: 11.08.2023.

Për mendimin e ekspertit shqyrtues duke u mbështetur në sqarimet e lartë përmendura ky pretendim ankimor nuk është i qëndrueshëm."

Sipas të thënave më sipër, ekspertja shqyrtuese i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Bahri Asllani", Argumentimi në raportin e ekspertes shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin raportit të ekspertes shqyrtuese. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Bahri Asllani", **te**pa bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor. Në ketë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesat në ketë rast.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i saj janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – "Korporata Energjetike e Kosovës" sh.a.të datës 20.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me transformator 400MVA, 24 400 kV për njësinë B1" me nr. të prokurimit: KEK-23-7573-1-1-1.

Paneli Shqyrtues në bazë të provave të paraqitura në raportin e ekspertizës dhe konstatimit të ekspertit shqyrtues, vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional konform nenit 59 par. 1 te LPP-së, ku thote: "*Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës*", atëherë në zabim të nenit 1 të LPP-së dhe me qëllim që mos ta prolongohet ky aktivitet i prokurimit edhe më tutje dhe në mungesë të ndonjë argumenti bindës se OE i rekomanduar mund të jetë i papërgjegjshëm atëherë paneli vlerëson se është në përgjegjësi të AK edhe përzgjedhja e OE të rekomanduar për kontratë. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24

paragrafi 2 të LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është i pabazuar dhe refuzohet, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e panelit.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur ne konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik. Si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- OE - **Bahri Asllani**
- Arkivës së OSHP-së: